

MEGAGROUT-101

Llaç çimentoje i lëngshëm që nuk tkurret dhe me rezistencë të lartë për mbështetjen dhe fiksimin e saktë të makinerive

Përshkrimi

Llaç i lëngshëm me bazë çimentoje me aditivë specialë, pa tkurrje dhe me rezistencë të lartë. Ai ofron:

- Rrjedhshmëri shumë të mirë pa u ndarë në shtresa.
- Fortësi fillestare dhe përfundimtare të lartë.
- Ngjitje efikase në hekur dhe beton.
- Rezistencë ndaj goditjeve dhe dridhjeve.
- Depërtueshmëri e ulët e ujit.

I certifikuar në përputhje me ASTM C 1107-99 dhe i klasifikuar edhe si stuko e tipit C. I certifikuar gjithashtu sipas EN 1504-3 dhe EN 1504-6, i klasifikuar si llaç CC R4 për riparime betoni dhe si produkt ankorimi për forcimin e shufrave të çelikut përkatësisht. Nr. i certifikatës: 2032-CPR-10.11. Mban markimin CE.

Fushat e përdorimit

MEGAGROUT-101 është i përshtatshëm për:

- Mbështetjen dhe fiksimin e makinerive.
- Ankorime.
- Formimin e bazamenteve mbështetëse të makinerive të precizonit.

Të dhënat teknike

Trajta: pluhur çimentoje

Ngjyra: gri

Uji që nevojitet: 3,50 kg për një thes 25 kg

Densiteti i volumit të llaçit të thatë: $1,75 \pm 0,20$ kg/l

Densiteti i volumit të llaçit të njomë: $2,35 \pm 0,20$ kg/l

Rezistenca në shtypje:

- Pas 24 orësh: $55,00 \pm 5,00$ N/mm²
- Pas 7 ditësh: $75,00 \pm 8,00$ N/mm²
- Pas 28 ditësh: $85,00 \pm 10,00$ N/mm²

Rezistenca

në përkulje: $11,00 \pm 2,00$ N/mm²

Koha e

punueshmërisë: 1 orë në +20°C

Trashësia maks.

për shtresë: 10 cm

Udhëzimet e përdorimit

1. Nënshtrësia

Sipërfaqja duhet të jetë e pastër, pa pluhur, graso etj. Gjithashtu, ajo duhet të bëhet e ashpër me qëllim që të garantohet ngjitja e duhur e llaçit të lëngshëm në të. Përpara përdorimit rekomandohet njomja totale e nënshtrësës.

2. Përdorimi

Pas përzierjes me ujin MEGAGROUT-101 është një përzierje e lëngshme dhe me kokrriza të imëta, dhe pjesë të saj mund të rrjedhin në pjesët bashkuese të elementeve të veçantë të betoformës.

Prandaj, bashkimet e betoformës duhet të izolojnë me çimenton me ngrirje të shpejtë AQUAFIX ose me llaçin meremetues me mpiksje të shpejtë RAPICRET.

MEGAGROUT-101 hidhet gradualisht në 3 kg ujë dhe përziehet mirë me ndihmën e një mikseri me xhiro të ulëta (300 rrot/min), derisa të formohet një masë e lëngshme uniforme. Gjatë trazimit shtohet një sasi shtesë uji deri në 0,50 kg, derisa të arrihet rrjedhshmëria e dëshiruar e llaçit. Më pas, përzierja derdhet duke bërë kujdes që të evitohet formimi i flluskave të ajrit. Në çdo rast duhet të siguroheni që llaçi i lëngshëm ka mbushur çdo hapësirë midis armaturës dhe konstruksionit ekzistues.

Sipërfaqet e krijuara me MEGAGROUT-101 dhe që janë të ekspozuara në ajër të hapur duhet të mbahen të njoma të paktën për 24 orë, duke u mbuluar me leckë të lagura ose fletë polietilene.

MEGAGROUT-101

Konsumi

Rreth 21,5 kg/m²/cm të trashësisë së shtresës ose 2,1 kg për mbushjen e një vëllimi prej 1 litër.

Ambalazhimi

MEGAGROUT-101 ofrohet në thasë letre 25 kg.

Magazinimi

Të paktën 12 muaj në thasë të izoluar dhe në ambiente të thata.

Shënime

- Temperatura gjatë aplikimit duhet të jetë nga +5°C deri në +30°C.
- Materiali që ka filluar të mpikset nuk duhet "të zbutet" përsëri me ujë.
- Produkti e ruan rrjedhshmërinë e tij për rreth 60 minuta në temperaturat midis +15°C dhe +25°C.
- Në temperatura të larta rekomandohet që thasët të ruhen në një vend të freskët, si dhe gjithashtu përzierja e materialit duhet të bëhet me ujë të ftohtë që të ketë rrjedhshmërinë e duhur për një kohëzgjatje të mjaftueshme (rreth 60 minuta).
- Në temperatura të ulëta dhe sa herë që kërkohet arritja e shpejtë e fortësisë, rekomandohet përzierja e materialit me ujë të vakët dhe mbrojtja nga i ftohti duke vendosur mbulesa izoluese termike mbi armaturë.
- Produkti përmban çimento, e cila vepron si alkaline me ujin dhe klasifikohet si irritues.
- Ndiqni udhëzimet për përdorimin e sigurt dhe masat paraprake të shkruara mbi paketim.



2032

ISOMAT S.A.

17th km Thessaloniki – Ag. Athanasios
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece

10

2032-CPR-10.11

EN 1504-3

Concrete repair product for structural repair CC
mortar (based on hydraulic cement)

DoP No.: MEGAGROUT-101/1210-03

Compressive strength: class R4

Chloride ion content: ≤ 0.05%

Adhesive Bond: ≥ 2.0 MPa

Carbonation resistance: Pass

Elastic modulus: ≥ 20 GPa

Thermal compatibility part 1: ≥ 2.0 MPa

Capillary absorption: ≤ 0.5 · kg · m⁻² · h^{-0.5}

Dangerous substances: comply with 5.4

Reaction to fire: Euroclass A1



MEGAGROUT-101



2032

ISOMAT S.A.

17th km Thessaloniki – Ag. Athanasios
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece

18

2032-CPR-10.11

EN 1504-6

DoP No: MEGAGROUT-101 / 1274-01

Anchoring of reinforcing steel bar

Pull-out strength – displacement $\leq 0,6\text{mm}$ at
load of 75 kN

Chloride ion content: 0,00%

Reaction to fire: Euroclass A1

Dangerous substances: comply with 5.3

ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:

17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 722 475

www.isomat.al e-mail: support@isomat.eu

